REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**
**NR . 35 , DATË 31 : 05 .2024**

**PËR**
**"MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË GJIROKASTËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. ÇEZAR GJOKSI , I CILI ËSHTË DËMTUAR NGA DJEGIA E BANESËS SË TIJ PRIVATE, SI REZULTAT I RËNIES SË ZJARRIT"**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" , Ligjin Nr.9936 , datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar, Ligjin Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" , Udhëzimin Nr.09 , datë 23.03.2018. "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" , V.KM Nr.329 , datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprime njerëzore" , V.K.B Nr. datë 14/12/2023 "Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024", Këshilli I Bashkisë në mbledhjen e datës 31 : 05 : 2024

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Gjirokastër për mbështetjen financiare për shtetasin Çezar Gjoksi , për dëmtimet e banesës së tij si pasojë e rënies së zjarrit
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Gjirokastër
3. T'i akordojë familjës së shtetasit Z. Çezar Gjoksi , ndihmë financiare në vlerën prej 200.000 (dyqind mijë) lekë,nga fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2024
   **Prog.AD115, Kap.01, Art 606.Kod produkti V091AAC**
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Çezar Gjoksi pwrcaktohet sipas kritereve të V.K.M-së 329, datë 16.05.2012.

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastër, Shqipëri. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796